



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 337/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Laziç dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendlorur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Ranillug, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) për shkak të ndryshimit të listave të votuesve, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

## **VENDIM**

**Hidhet poshtë** si e pa lejuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Ranillug .

## **Arsyetim**

Me datën 23.10.2013, LDK-ja , ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, neve na u është bërë e pa drejtë nga KKZ-ja dhe KQZ-ja pasi që nuk jemi pjesë e listës së votuesve të komunës së Ranillugut . Në komunë të re të Ranillugut garojmë si subjekt politik LDK dhe banorë rezident janë 200 votues shqiptar përafërsisht . Më tutje ka theksuar se, ne kemi bërë kërkuesat në KKZ dhe KQZ për ndryshimin e listës së votuesve dhe kemi ofruar fakte se banorët janë me dokumente votues të Ranillugut, por që ndryshimet nuk i kanë bërë edhe pse ne iu kemi përmbytj afateve ligjore .

Për më tepër ka kërkuar që ankesa të na pranohet dhe të na bëhet e mundshme të ndryshohet lista votuese dhe të shfrytëzojmë të drejtën tonë për të votuar në vendin ku jetojmë .

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

**ankesa është e palejuar**

Me ankesën e parashtruar nga LDK-ja, pretendohet se iu është bërë e padrejtë pas kërkeshave të ushtruar në KKZ dhe KQZ-ja pasi që nuk iu janë ndryshuar listat e votuesve në komunën e Ranillugut, me arsyetimin se banorët i takojnë po të njëjtës komunë dhe janë rezident në atë vend, mirëpo një veprim i kësaj natyre nuk është nën autoritetin e PZAP-it për të vendosur në lidhje me ndryshimin e listave të votuesve.

PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë, andaj nuk bie në juridikcionin e saj, gjë që nuk e bënë përgjegjës për të vendosur, prandaj ankesa vlerësohet si e pa lejuar duke u bazuar në nenin 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 337/2013 më datën 25.10.2013



Kryesuesi i Panelit

Nehat Idrizi

#### **Këshillë Juridike:**

PZAP nuk do t'i pranojë kërkeshat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.